
	REPUBLIKA E KOSOVËS REPUBLIKA KOSOVA REPUBLIC OF KOSOVA KOMUNA E RAHOVECIT OPSTINA ORAHOVAC MUNICIPALITY OF RAHOVEC	
---	--	---

Për:	Operatorë Ekonomik: KSF MAJOR SH.A. me adresë në Prizren Operatorëve Ekonomik Të gjitha palëve të interesuar
Nga:	Astrit Mullabazi, Zyrtar Përgjegjës i Prokurimit
Lënda:	VENDIM për Rishqyrtim të Kërkesës
Datë:	18.06.2026

Zyrtari Përgjegjës i Prokurimit i Komunës së Rahovecit, në mbështetje të nenit 108/A, paragrafi 10 të Ligjit Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092, si dhe duke u bazuar në nenin 63 të Rregullores Nr. 001/2022 për Prokurim Publik, duke vendosur sipas **Kërkesës për Rishqyrtim**, të datës: **18.06.2026**, të parashtruar nga Operatori Ekonomik: **KSF MAJOR SH.A.** me adresë në **Prizren**, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: **Ofrimi i shërbimeve të sigurimit fizik të objekteve të Komunës së Rahovecit**, me Numër të prokurimit: **623-26-4363-2-1-1**, Numër i brendshëm: **623-26-024-2-1-1**, nxjerr:

V E N D I M

- I. **REFUZOHET** kërkesa e parashtruar nga Operatori Ekonomik: **KSF MAJOR SH.A.** me adresë në **Prizren**, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: **Ofrimi i shërbimeve të sigurimit fizik të objekteve të Komunës së Rahovecit**, me Numër të prokurimit: **623-26-4363-2-1-1**, Numër i brendshëm: **623-26-024-2-1-1**, kundër Njoftimit për Kontratë, të datës: **08.06.2026**, të publikuar në ueb-faqe: <https://e-prokurimi.rks-gov.net>
- II. Autoriteti Kontraktues vendos të vazhdoj me Njoftimin për Kontratë për aktivitetin e prokurimit: **Ofrimi i shërbimeve të sigurimit fizik të objekteve të Komunës së Rahovecit**, me Numër të prokurimit: **623-26-4363-2-1-1**, Numër i brendshëm: **623-26-024-2-1-1**
- III. Ky vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit dhe do të publikohet për të gjitha palët në platformën elektronik në adresën: <https://e-prokurimi.rks-gov.net>

ARSYETIM

Operatori Ekonomik: **KSF MAJOR SH.A.** me adresë në **Prizren**, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: **Ofrimi i shërbimeve të sigurimit fizik të objekteve të Komunës së Rahovecit**, me Numër të prokurimit: **623-26-4363-2-1-1**, Numër i brendshëm: **623-26-024-2-1-1**, kundër Njoftimit për Kontratë, të datës: **08.06.2026**, të publikuar në ueb-faqe: <https://e-prokurimi.rks-gov.net>, ka bërë Kërkesë për Rishqyrtim me datë: **18.06.2026**, sipas nenit 108/A, të Ligjit për Prokurimin Publik (LPP) me Nr. 04/L-042.

Pas analizimit të pretendimeve ankimore, Dosjes së Tenderit, nevojave operative të Komunës së Rahovecit dhe legjislacionit në fuqi, Autoriteti Kontraktues konstaton se asnjëri prej pretendimeve **nuk është i bazuar**.

Objekti i kontratës nuk përfshin vetëm vendosjen pasive të rojeve në objekte, por sigurinë profesionale dhe të integruar të objekteve komunale, mbrojtjen e personelit, qytetarëve, dokumentacionit zyrtar dhe pasurisë publike. Për këtë arsye, Autoriteti Kontraktues gëzon të drejtën ligjore që të kërkojë kapacitete profesionale, teknike dhe organizative që garantojnë realizimin e kontratës me standardet më të larta të sigurisë.

Përgjigje I. LIDHUR ME PRETENDIMIN PËR SHKELJE TË NENIT 1 TË LPP-së

Vlerësimi i AK-së: Ky pretendim refuzohet **si i pabazuar**.

Neni 1 i LPP-së nuk ndalon Autoritetin Kontraktues të vendosë kritere profesionale dhe teknike që sigurojnë realizimin cilësor dhe të sigurt të kontratës. Përkundrazi, AK ka obligim ligjor të sigurojë që operatorët ekonomikë të posedojnë kapacitetet e nevojshme profesionale, teknike dhe organizative për realizimin e kontratës.

Kriteret e vendosura nuk kufizojnë konkurrencën, por synojnë garantimin e sigurisë së objekteve komunale, mbrojtjen e pasurisë publike dhe sigurimin e reagimit profesional në situata të ndryshme operative. Çdo operator ekonomik që ushtron veprimtari në fushën e sigurisë private ka mundësi objektive t'i plotësojë këto kërkesa qoftë vetë, qoftë në bashkimin e një grupi të operatorëve ekonomik.

Prandaj nuk ekziston asnjë shkelje e Nenit 1 të LPP-së.

Përgjigje II. LIDHUR ME PRETENDIMIN PËR SHKELJE TË NENIT 7, 27, 28 TË LPP-së

Vlerësimi i AK-së: Ky pretendim refuzohet **si i pabazuar**.

Të gjitha kriteret e përcaktuara në Dosjen e Tenderit aplikohen në mënyrë të barabartë për të gjithë operatorët ekonomikë pa asnjë dallim.

Fakti që një operator ekonomik mund të mos i posedojë kapacitetet e kërkuara nuk e bën kriterin diskriminues.

Praktika e vazhdueshme e OSHP-së dhe e gjykatave administrative ka konfirmuar se kriteret konsiderohen diskriminuese vetëm kur favorizojnë drejtpërdrejt një operator të caktuar ose kur nuk kanë lidhje me nevojat e kontratës.

Në rastin konkret, të gjitha kriteret janë vendosur për arsye operative, profesionale dhe të sigurisë dhe janë të zbatueshme për secilin operator ekonomik të licencuar.

Po ashtu, Autoriteti Kontraktues vlerëson se referimi i OE ankues në vendimet dhe raportet e ekspertëve të OSHP-së nuk mund të merret si bazë detyruese për këtë aktivitet të prokurimit. Këto vendime janë nxjerrë në rrethana të tjera faktike, për autoritete të tjera kontraktuese, me nevoja të ndryshme operative, specifikime teknike të ndryshme dhe kërkesa të veçanta që lidhen me natyrën e kontratave përkatëse.

Çdo aktivitet i prokurimit përbën rast të veçantë administrativ dhe duhet të vlerësohet mbi bazën e nevojave konkrete të Autoritetit Kontraktues, objektit të kontratës, vlerës së kontratës, rreziqeve që lidhen me realizimin e saj dhe interesit publik që synohet të mbrohet. Për këtë arsye, vendimet e OSHP-së në raste të tjera nuk krijojnë precedent detyrues juridik dhe nuk mund të zbatohen automatikisht në çdo procedurë tjetër të prokurimit pa u analizuar rrethanat specifike të secilit rast.

Prandaj nuk ekziston asnjë shkelje.

Përgjigje III. PRETENDIMI LIDHUR ME MENAXHERIN E PROJEKTIT

Ankuesi pretendon se kërkesa që Menaxheri i Projektit të posedojë licenca për shërbime themelore dhe shërbime të specializuara përbën kriter diskriminues.

Vlerësimi i AK-së: Ky pretendim refuzohet **si i pabazuar**.

Menaxheri i Projektit është personi përgjegjës për menaxhimin operacional, koordinimin e stafit, trajtimin e incidenteve të sigurisë dhe mbikëqyrjen e zbatimit të kontratës.

Objektet komunale përfshijnë institucione me nivel të ndryshëm të rrezikut, ku përdoren njëkohësisht: masa të sigurisë fizike; sisteme alarmi; sisteme vëzhgimi elektronik; pajisje teknike të sigurisë.

Për këtë arsye, kërkesa që menaxheri të posedojë njohuri dhe kompetenca në të dyja fushat nuk është diskriminuese, por garanton menaxhim profesional të kontratës.

AK nuk ka kërkuar bashkimin e dy pozitave të ndryshme ligjore, por ka kërkuar që personi përgjegjës për menaxhimin e kontratës të posedojë njohuri dhe kompetenca të zgjeruara profesionale.

As Ligji për Shërbimet Private të Sigurisë dhe as aktet nënligjore nuk ndalojnë që një person të posedojë më shumë se një licencë profesionale.

Përkundrazi, posedimi i dy licencave përfaqëson kualifikim shtesë profesional dhe jo kufizim ligjor.

Menaxheri i projektit është personi përgjegjës për koordinimin e të gjitha aktiviteteve të sigurisë në kuadër të kontratës dhe është krejtësisht e arsyeshme që ai të ketë njohuri si në sigurinë fizike ashtu edhe në sistemet elektronike të sigurisë.

Asnjë dispozitë e Ligjit për Shërbimet Private të Sigurisë **nuk ndalon që një person të posedojë më shumë se një licencë profesionale** apo të ketë kompetenca në më shumë fusha të sigurisë.

Kriteri është vendosur në funksion të realizimit të kontratës dhe jo për favorizimin e ndonjë operatori ekonomik.

Prandaj nuk ekziston asnjë shkelje.

Përgjigje IV. PRETENDIMI LIDHUR ME PESË OPERATORËT E CERTIFIKUAR PËR MONITORIM DHE VËZHGIM ELEKTRONIK

Ankuesi pretendon se kërkesa për minimum pesë operatorë të certifikuar për monitorim elektronik nuk lidhet me objektin e kontratës.

Vlerësimi i AK-së: Ky pretendim refuzohet **si i pabazuar**.

Autoriteti Kontraktues nuk ka kërkuar këta operatorë për të realizuar një kontratë të veçantë monitorimi elektronik, por si kapacitet mbështetës operacional për reagim ndaj incidenteve, verifikim të alarmeve, koordinim të ngjarjeve të sigurisë dhe ndërveprim me sistemet teknike të instaluar në objektet komunale. Siguria moderne nuk mund të trajtohet vetëm si prezencë fizike e rojeve.

Praktika bashkëkohore e sigurisë kërkon integrimin e sigurisë fizike me sistemet teknike të mbikëqyrjes.

Edhe pse kontrata ka për objekt sigurimin fizik, natyra e shërbimeve të sigurisë kërkon koordinim të vazhdueshëm me sistemet elektronike të sigurisë.

Objektet komunale posedojnë pajisje elektronike të cilat në raste emergjente kërkojnë verifikim, monitorim dhe koordinim me personelin fizik në terren.

Operatorët e monitorimit elektronik nuk zëvendësojnë rojet fizike, por përbëjnë kapacitet shtesë profesional që garanton reagim më të shpejtë dhe mbulim më efikas të situatave të sigurisë.

Pesë operatorët e kërkuar përbëjnë kapacitet minimal organizativ për të siguruar funksionim të pandërprerë 24/7, zëvendësime gjatë pushimeve, sëmundjeve dhe rasteve emergjente.

Autoriteti Kontraktues ka diskrecion ligjor që të përcaktojë nivelin e kapacitetit profesional të nevojshëm për realizimin e kontratës, përderisa ky kriter zbatohet në mënyrë të barabartë për të gjithë operatorët ekonomikë.

Ankuesi nuk ka ofruar asnjë provë se kërkesa është e paarritshme për operatorët ekonomikë të licencuar në treg.

Prandaj nuk ekziston asnjë shkelje.

Përgjigje V. PRETENDIMI LIDHUR ME MENAXHERIN E RISKUT

Ankuesi pretendon se kërkesa për Menaxher të Riskut pretendon se Ligji për Shërbimet Private të Sigurisë nuk e kërkon.

Vlerësimi i AK-së: Ky pretendim refuzohet si i pabazuar.

Menaxhimi i riskut është një element thelbësor në sektorin e sigurisë private.

Sigurimi fizik ka për objekt identifikimin, analizimin, vlerësimin dhe minimizimin e rreziqeve që mund të cenojnë personat, objektet dhe pasurinë publike.

Prandaj kërkesa për Menaxher Risku është plotësisht në përputhje me natyrën e kontratës dhe paraqet një kapacitet profesional shtesë që garanton realizim më cilësor të shërbimeve, e që ne nuk kemi potencuar se kjo kërkesë ndërlidhet me Ligjin që ju e keni cekur.

Ligji për Prokurimin Publik nuk e ndalon vendosjen e kritereve të tilla kur ato lidhen me realizimin e kontratës.

Për më tepër, ankuesi nuk ka paraqitur asnjë vendim administrativ apo dispozitë ligjore që ndalon posedimin e një personi me këtë kualifikim sipas kërkesave të Dosjes së Tenderit.

Përkundrazi Autoriteti Kontraktues në Dosjen e tenderit ka cekur Ligjin dhe Udhëzimin Administrativ ku është bazuar për një kërkesë të tillë, po ashtu kërkesa e njëjtë përdoret nga të gjitha Autoritetet Kontraktuese për të njëjtin shërbim për qëllime të sigurimit fizik.

Kërkesa për një person të kualifikuar në Menaxhim të Riskut është vendosur në mbështetje të nenit 51 të Ligjit për Prokurimin Publik, me qëllim garantimin e kapaciteteve profesionale për identifikimin, vlerësimin dhe trajtimin e rreziqeve që mund të cenojnë sigurinë e objekteve komunale, personelit dhe pasurisë publike. Menaxhimi i riskut përbën element thelbësor të veprimtarisë së sigurisë private dhe lidhet drejtpërdrejt me realizimin efektiv të kontratës. Kjo kërkesë nuk është diskriminuese, por synon sigurimin e cilësisë, vazhdimësisë dhe efikasitetit të shërbimeve të sigurisë në interes të Autoritetit Kontraktues.

Prandaj nuk ekziston asnjë shkelje.

Përgjigje VI. PRETENDIMI LIDHUR ME MEMORANDUMIN DHE DOKUMENTET E INSTRUKTORËVE

Ankuesi pretendon se kërkesa për dokumentacionin e instruktorëve është e panevojshme dhe diskriminuese.

Vlerësimi i AK-së: Ky pretendim refuzohet **si i pabazuar**.

Vetë Memorandumi i Bashkëpunimit nuk garanton ekzistimin e kapaciteteve profesionale të deklaruara.

AK ka të drejtë ligjore të verifikojë nëse personeli i deklaruar nga subjektet mbështetëse posedon kualifikimet dhe autorizimet e nevojshme për realizimin e obligimeve kontraktuese.

Kërkimi i dokumentacionit të instruktorëve nuk cenon asnjë dispozitë ligjore dhe nuk paraqet kërkesë disproporcionale.

Përkundrazi, kjo siguron transparencë, verifikueshmëri dhe vërtetim të kapaciteteve reale profesionale mbi të cilat operatori ekonomik mbështetet.

Trajnimi i stafit të sigurisë përbën një nga elementet më kritike për realizimin e suksesshëm të kontratës.

Autoriteti Kontraktues ka të drejtë të verifikojë jo vetëm ekzistencën e një marrëveshjeje me qendrën trajnuese, por edhe kapacitetin real profesional të subjektit që do të kryejë trajnimet.

Marrëveshja e bashkëpunimit, në vetvete, nuk garanton cilësinë e trajnimit.

Për këtë arsye është kërkuar dokumentacioni që dëshmon se trajnimet do të realizohen nga instruktorë të kualifikuar dhe kompetentë.

Ky kriter: lidhet drejtpërdrejt me cilësinë e shërbimit; garanton profesionalizmin e stafit të sigurisë; ul rrezikun operacional gjatë realizimit të kontratës; siguron mbrojtjen e interesit publik.

Kërkesa aplikohet në mënyrë të barabartë ndaj të gjithë operatorëve ekonomikë dhe nuk favorizon asnjë operator të veçantë.

Prandaj nuk ekziston asnjë shkelje.

Përgjigje VII. LIDHUR ME PRETENDIMIN PËR SHKELJE TË PIKËS 20.80 TË RRUOPP

Vlerësimi i AK-së: Ky pretendim refuzohet **si i pabazuar**.

Ankuesi nuk ka ofruar asnjë provë konkrete që kriteret janë hartuar për të favorizuar një operator ekonomik të caktuar, **përkundrazi dispozita në të cilën jeni thirrur Neni 20.80 nuk ekziston as në Rregullore e as në Udhëzuesin Operativ të cilat janë në fuqi.**

Pretendimet e ngritura mbeten deklarative dhe të pambështetura me prova.

Të gjitha kriteret janë të bazuara në nevojat reale operative të Autoritetit Kontraktues dhe në kërkesën për sigurim profesional të objekteve komunale.

Prandaj nuk ekziston asnjë shkelje.

Përgjigje VIII. LIDHUR ME MOSRESPEKTIMIN E PRAKTIKËS SË KONSOLIDUAR TË OSHP-së

Vlerësimi i AK-së: Ky pretendim refuzohet **si i pabazuar**.

Çdo aktivitet i prokurimit vlerësohet mbi bazën e fakteve, nevojave operative dhe rrethanave specifike të rastit konkret.

Vendimet e OSHP-së në raste të tjera nuk mund të aplikohen automatikisht në çdo aktivitet të prokurimit.

Dosja e Tenderit e Komunës së Rahovecit është hartuar mbi bazën e nevojave konkrete të sigurisë së objekteve komunale dhe nuk mund të krahasohet mekanikisht me raste të tjera.

Prandaj nuk ekziston asnjë shkelje.

Përcaktimi i këtyre kriterëve, të këtyre kërkesave ka të bëjë lëndën së natyrës së Projektit në fjalë, dhe gjithashtu kërkesat e tillë janë të domosdoshme për Aktivitetin e Prokurimit në fjalë.

Autoriteti Kontraktues gjatë përcaktimit të kërkesave dhe dëshmive është kujdesur që në maximum ti respektoj parimet thelbësore të përcaktuara me LPP siç janë, **Konkurrenca, Trajtimi i barabarte dhe jo diskriminim**. Gjithashtu Autoriteti Kontraktues është kujdesur që të vendos vetëm kërkesa dhe dëshmi në pajtueshmëri me objektin e kontratës. **Kërkesat e vendosura në Dosjen e Tenderit dhe në Njoftimin për Kontratë sa i përket Kërkesave dhe dëshmive mbi mundësitë teknike dhe/ose profesionale** janë vendosur gjithashtu duke u bazuar plotësisht në nenin 69 paragrafin 6.1 dhe paragrafin 6.4 të Ligjit të Prokurimit Publik.

Kërkesa janë absolutisht të domosdoshme për të konfirmuar nëse Operatori Ekonomik potencial, ka kapacitetin e nevojshme teknik dhe profesional për të realizuar këtë projekt me sukses, në mënyrë efikase dhe efektive.

Këto kërkesat/dëshmitë kanë qenë të monitoruara nga **KRPP Departamenti i Monitorimit**, ku neve si Autoritet Kontraktues nuk na është dhënë ndonjë vërejtjeje për të larguar nga Njoftimi për Kontratë dhe Dosja e Tenderit ndonjë kërkesë, përveç se të konstatojmë se të njëjtat janë të nevojshme dhe në përputhje me kontratën, për të cilat kemi dhënë arsyet dhe argumentet tona.

Nga konstatimet e lartcekur u vendos si në dispozitave të këtij Vendimi.

Kjo procedurë është trajtuar konform Ligjit Nr. 04/042, Ligji për Prokurimin Publik në Republikën e Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-92.

Në bazë të Rregullores për Prokurimin Publik, **Neni 63 Vendimi i Autoritetit Kontraktues:**

63.1.1 **Të refuzojë** kërkesën për shqyrtim sipas Nenit 62 të kësaj rregullore:

b. Kurdo që refuzimi i kërkesës ndërlidhet me **njoftimet për kontratë, dokumentet e tenderit, Autoriteti kontraktues vazhdon më tutje me aktivitetin e prokurimit** duke vlerësuar dhe konsideruar arsyet e refuzimit dhe rrethanat në të cilat ndodhet aktiviteti i prokurimit.

Vendimi Publikohet:

Në platformën elektronike në adresën: <https://e-prokurimi.rks-gov.net>